

KONKLUZAT E DAKORDUARA 2 KORRIK 2011

Pranimi i Diplomave Universitare

1. Në përputhje me praktikat më të mira evropiane, studentët duhet të kenë qasje në programet arsimore dhe në mundësi punësimi në tërë rajonin për të shfrytëzuar si është më së miri shkathtësitë dhe talentet e tyre.
2. Të dy palët janë pajtuar në parim që të zgjidhin çështjen e pranimi të diplomave universitare përmes një trupi ndërkombëtar të dakorduar reciprokisht ose përmes një institucioni akademik të palës së tretë.
3. Detajet do të finalizohen në takimin e radhës së Dialogut.

KONKLUZIONET E DAKORDUARA – 21 NËNTOR 2011

Pranimi i diplomave universitare

1. Në bazë të konkluzioneve operacionale të 2 korrikut 2011 për pranimin e diplomave universitare, palët bien dakord që të kërkojnë nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane që të bëjnë certifikimin e diplomave universitare të lëshuara nga secili universitetet që të përdoren nga tjetri në lidhje me edukimin e mëtejshëm dhe/ose punësimet publike;
2. Gjatë verifikimit të diplomave universitare të lëshuara nga institucionet e autorizuara në përputhje me praktikat më të mira Evropiane, certifikimi do të bëhet nga një Komitet i ekspertëve akademi evropianë, themeluar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane.
3. Shtojcave të Diploma dhe transkripti i të dhënave që u prezantuan gjatë Dialogut, dhe konkluzionet do t'i bashkëngjiten diplomës universitare. Ajo do të jetë për autoritetet e secilës palë për të vendosur se cili nga dokumentet janë të vlefshme për këtë proces, me kusht që efekti është pranimi i kualifikimit i prezantuar nga diploma;
4. BE-ja do të bëjë çdo për të siguruar zbatimin e konkluzioneve të mësipërme nga 1 Janari 2012.